



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Mars 2021

Nr: 5

UDHËZIM

PËR

**PROCEDURAT E HEDHJES SË SHORTIT PËR CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË
PROPOZOJNË ANËTARIN E TRETË DHE TË KATËRT TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT
TË VOTAVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe nenin 96 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

Objekti

Ky udhëzim ka objekt të përcaktojë rregullat për hedhjen e shortit ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive politike të opozitës parlamentare, në përputhje me parashikimet e nenit 96 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2

Partitë politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV

1. Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë Kryetarin dhe Zv.kryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së



partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë.

2. Shorti për anëtarin e tretë të GNV-ve, hidhet ndërmjet partive politike të shumicës parlamentare, të cilave i ka lindur e drejta të marrin pjesë në short sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Shorti për anëtarin e katërt të GNV-ve, hidhet ndërmjet partive politike të opozitës parlamentare, të cilave i ka lindur e drejta të marrin pjesë në short sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të GNV-ve, e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare.

Neni 3

Veprime paraprake për hedhjen e shortit

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, organizon në seancë publike hedhjen e shortit ndërmjet partive politike sipas nenit 2, paragrafët 2 dhe 3, të këtij Udhëzimi.
2. Emrat e partive politike pjesëmarrëse në short, data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së dhe shpallen në këndin njoftime, në hyrje të godinës së KQZ-së.
3. Hedhja e shortit zhvillohet nga administrata e KQZ-së, në prani të përfaqësuesve të partive politike që marrin pjesë në short, të përfaqësuesve të partive politike të akredituar në KQZ, dhe përfaqësuesve të mediave.
4. Në datën dhe në orën e caktuar për zhvillimin e shortit, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e përfaqësuesve të partive politike pjesëmarrëse në short, dhe i fton të zenë vendet e caktuara.
5. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të partive politike pjesëmarrëse në short, pasi njoftimet janë publikuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk pezullon procedurat e shortit. Në këtë rast Komisioneri, me vendim të ndërmjetëm, cakton një punonjës të administratës së KQZ-së, të tërheqë shortin për partinë politike, përfaqësues i së cilës nuk është prezent.

Neni 4

Procedura e shortit kur në listë janë dy parti politike



1. Kur në listën e partive politike që marrin pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të tretë të GNV, numri i partive politike është dy, ndiqet kjo procedurë:
 - a) për efekt të shortit, tavolinat e numërimit të votave të gjithë VNV-ve në rang vendi mbajnë numërtimin sipas parashikimeve të nenit 6, paragrafi 2, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 3, datë 9.02.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”;
 - b) emrat e partive pjesëmarrëse në short shkruhen në shirita letre, të cilët mbyllen në gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë transparente;
 - c) dy shirita letre ku shkruhet “Tavolinat e numërimit me numër tek” dhe shiriti tjetër “Tavolinat e numërimit me numër çift”, mbyllen në dy gogla me formë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë të dytë transparente;
 - d) një nëpunës i administratës së KQZ-së, tërheq njërën nga goglat në enën e parë, e hap gogllën, dhe ia dorëzon shiritin e letrës që gjendet brenda saj, Sekretarit të KQZ-së. Emri i partisë politike në shiritin e letrës lexohet me zë të lartë dhe i tregohet të gjithë të pranishmëve;
 - e) përfaqësuesi i partisë, emri i së cilës ndodhet në shiritin e letrës brenda gogllës së tërhequr ka të drejtën të tërheqë gogllën në enën e dytë;
 - f) partisë politike, përfaqësuesi i së cilës tërhoqi gogllën në enën e dytë, i lind e drejta të propozojë anëtarin e tretë të GNV-ve, në tavolinat me numër tek ose çift, sipas përcaktimit në shiritin e letrës që ndodhet brenda gogllës së tërhequr, në të gjithë ZAZ-të;
 - g) partisë politike tjetër, që merr pjesë në short, i lind e drejta për të propozuar anëtarin e tretë të GNV-ve në të gjithë ZAZ-të, në tavolinat me numër tek ose çift, sipas përcaktimit në shiritin e letrës që ndodhet brenda gogllës të mbetur në enë.
2. E njëjta procedurë ndiqet kur në listën e partive politike që marrin pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të katërt të GNV, numri i partive politike është dy.
3. Rezultati i shortit sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, ka efekt për të gjitha ZAZ-të.
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin e shortit.

Neni 5

Procedura e shortit kur në listë janë më shumë se dy parti politike

- 1 Kur në listën e partive politike që marrin pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të tretë të GNV, numri i partive politike është më shumë se dy, ndiqet kjo procedurë:



- a) emrat e partive pjesëmarrëse në short shkruhen në shirita letre, të cilët mbyllën në gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë transparente;
 - b) dy shirita letre ku shkruhet “Tavolinat e numërimit me numër tek” dhe shiriti tjetër “Tavolinat e numërimit me numër çift”, mbyllën në dy gogla me formë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë të dytë transparente;
 - c) një nëpunës i administratës së KQZ-së, në enën ku janë vendosur goglat ku janë mbyllur shiritat e letrës me emrat e partive politike:
 - i. tërheq një nga goglat, e hap atë dhe i dorëzon Sekretarit të KQZ-së shiritin e letrës që gjendet brenda saj. Emri i partisë politike në shiritin e letrës, lexohet me zë të lartë dhe i tregohet të pranishmëve;
 - ii. pas gogllës së parë, tërheq një gogël të dytë, e hap atë dhe i dorëzon Sekretarit të KQZ-së shiritin e letrës që gjendet brenda saj. Emri i partisë politike në shiritin e letrës, lexohet me zë të lartë dhe i tregohet të gjithë të pranishmëve;
 - ç) pas përcaktimit në këtë parashort, shiritat e letrës futen sërish në gogla, të cilat hidhen në enën përkatëse nga ku u tërhoqën;
 - d) përfaqësuesi i partisë, emri i së cilës ndodhet në shiritin e letrës brenda gogllës e cila u tërhoq e para, do të tërheqë i pari njëri nga goglat në enën e dytë;
 - dh) partisë politike, përfaqësuesi i së cilës tërhoqi gogllën në enën e dytë, i lind e drejta të propozojë anëtarin e tretë të GNV-ve në ZAZ-në përkatëse, në tavolinat me numër tek ose çift, sipas përcaktimit në shiritin e letrës që ndodhet brenda gogllës së tërhequr;
 - e) partisë politike tjetër, emri i së cilës ndodhet në shiritin e letrës brenda gogllës e cila u tërhoq e dyta, i lind e drejta për të propozuar anëtarin e tretë të GNV-ve në ZAZ-në përkatëse, në tavolinat me numër tek ose çift, sipas përcaktimit në shiritin e letrës që ndodhet brenda gogllës së mbetur në enë;
2. Procedura e hedhjes së shortit, përsëritet në të njëjtën mënyrë për të gjitha ZAZ-të.
 3. E njëjta procedurë ndiqet kur në listën e partive politike që marrin pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të katërt të GNV, numri i partive politike është më shumë se dy.
 5. Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim shpall rezultatin e shortit për çdo ZAZ.

Neni 6
Formimi kalimtar i GNV-ve

Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi, e drejta për propozimin e anëtarëve të GNV-ve, përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.

Neni 7
Shfuqizime

Udhëzimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr.19, datë 9.06.2009 “Për procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

